



BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT TË
KONTRATAVE TË INFRASTRUKTURËS

NDËRHYRJE MIRËMBAJTJE NË “BIBLIOTEKA” DHE “MUZEU I FOTOGRAFISË “GJON MILI””

RELACION TEKNIK



Drejtori i DPPTMKI - Ark. Ndrëçim Hoxha

Përgatiti - Ark. Edona Venxha

Ark. Dhimitër Këri

Tabela përmbledhëse

	HYRJE
1	OBJEKTI DHE QËLLIMI I NDËRHJRJES
2	PËRSHKRIMI TIPOLOGJIK I OBJEKTIT
3	ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE TË BIBLIOTEKËS
3.1	Patologjitë e lagështisë
3.2	Ndërhjrjet
4	KONCEPTI I NDËRHJRJES DHE ZGJIDHJA TEKNIKE
4.1	Zonat e degraduara
4.2	Ndërhjrjet
5	KONCEPTI I NDËRHJRJES DHE ZGJIDHJA TEKNIKE
5.1	Sistemi i hidroizolimit
5.2	Rehabilitimi i suvave
5.3	Trajtimi i fasadës
5.4	Sistemi i dyshemeve
5.5	Punime ndihmëse dhe përgatitore
6	KËRKESAT PËR MATERIALET DHE STANDARDET
7	PËRFUNDIME

1. OBJEKTI DHE QËLLIMI I NDËRHJRJES

Ky relacion teknik hartohet për të përshkruar, punimet e parashikuara për “Ndërhyrje, mirëmbajtje në “Biblioteka” dhe “Muzeu i fotografisë “Gjon Mili”. Kjo ndërhyrje mirëmbajtje lind si nevojë e degradimit të disa shtresave si pasojë e kushteve atmosferike të qytetit të Korçës. Qëllimi është kthimi i godinave në funksionin normal të tyre duke realizuar punimet e mëposhtme:

- hidroizolues dhe mbrojtës ndaj agjentëve atmosferikë
- funksional dhe ergonomik
- estetik dhe arkitektonik

Ndërhyrja klasifikohet si mirëmbajtje e thelluar (rehabilitim i pjesshëm) pa ndërhyrje në sistemin mbajtës të strukturës.

2. PËRSHKRIMI TIPOLOGJIK I OBJEKTITEVE

Objektet përfaqësojnë godina publike ekzistuese me funksion kulturor (bibliotekë dhe hapësira muzeale), të realizuara me sistem konstruktiv tradicional (beton arme në rastin e Bibliotekës / muraturë mbajtëse në rastin e Muzeut të fotografisë Gjon Mili) e përfunduar me shtresa mbështjellëse standarde (suva, fasadë, shtresa dyshemeje, etj.).

3. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE TË BIBLIOTEKËS

Foto të gjendjes ekzistuese të Bibliotekës:





Fotot e mësipërme janë bërë në hapsira e arkivës së bibliotekës. Kjo zonë ndodhet në korridorin lidhës së “Bibliotekës” me “Galerinë e Artit” në katin -1.



Bazuar në inspektimin viziv dhe vlerësimin teknik në terren, janë evidentuar këto problematika:

3.1. Patologjitë e lagështisë

- Prani e lagështisë kapilare në zonat në kontakt me terrenin
- Depërtim i fugaturave të shtresës së pllakave ekzistuese
- Infiltrime i ujit nëpërmjet fugave të degraduara të veshjes së murit me gurë në Galeria e Arteveme

- Degradim i shtresa bashkuese ndërmjetmureve te ferizolit të bibliotekes dhe shkalleve të shkallëve prej gurit në pjesa e jashtme.
- Amortizimi i shtresave mbrojtëse si pasojë e cikleve lagështi-tharje
- Degradim i suvave ekzistuese
- Mikroçarje dhe çarje sipërfaqësore (jo-strukturore)

3.2. Ndërhyrjet

Ndërhyrjet në objekt do të bëhën si më poshtë:

- Prishje e shtresave dhe rivendosje e pllakave të gurit ekzistuese
- Prishje veshje dhe rivendosje e pllakave të gurit
- Fugatimi i murit ekzistues në anën e Galerisë së Artit
- Hidroizolim me dy shtresa astar me bazë cemento. Pergatitur me bicomponent A+B sipërfaqe e pllakave qe do te hiqen. Lyerje me bicomponent e zonës së tavanit në arkivë.
- Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama
- Veshje fasade me pllaka guri (plintueset ne anen e bibliotekes)
- Lyerje të brendshme të zonës së arkivës.

4. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE TEK “MUZEU I FOTOGRAFISË “GJON MILI””

Nga inspektimi viziv në terren dhe vlerësimi teknik i elementeve përbërës të godinës, rezulton se objekti paraqet një sërë problematikash të lidhura kryesisht me amortizimin progresiv të shtresave mbështjellëse dhe ndikimin e faktorëve mjedisorë në kohë.

Foto të brendshme te ambienteve të Muzeut të fotografisë “Gjon Mili”

